

SHEMBULL

(KONTABILIZIMI I PJESËMARRJEVE KUR LEJOHET METODA E KAPITALIT¹)

Supozojmë se njësia ekonomike A zotëron 25% të kapitalit të njësisë ekonomike B, kapitali i të cilës është 20.000 eur. Kështu, investimi financiar fillestar i njësisë ekonomike A është në shumën 5.000 euro (25% * 20.000 euro). Njësia ekonomike A kontabilizon investimin si më poshtë:

D Investime financiare në pjesëmarrje 5.000 euro

K Mjete monetare në bankë 5.000 euro

Tab. 1 Pasqyrat individuale të pozicionit financiar të njësive ekonomike A dhe B në 31.12.20X0

	Njësia ekonomike A	Njësia ekonomike B
Aktive afatshkurtra	50.000	0
Investime financiare (tek njësia B)	5.000	
Toka, ndërtesa dhe impiante	60.000	20.000
TOTALI I AKTIVEVE	115.000	20.000
<hr/>		
Detyrime	75.000	0
Kapitali dhe rezervat	40.000	20.000
<i>Kapitali i nënshkruar</i>	<i>24.000</i>	<i>20.000</i>
<i>Rezervat</i>	<i>0</i>	<i>0</i>
<i>Fitimet e pashpërndara</i>	<i>16.000</i>	<i>0</i>
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT	115.000	20.000

Tab. 2 Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve të njësive ekonomike A dhe B në 31.12.20X1

	Njësia ekonomike A	Njësia ekonomike B
Të ardhurat nga shitja	100.000	40.000
Kosto e mallrave të shitur	80.000	28.000
Të ardhurat nga investimet financiare	?	x
FITIMI NETO	?	12.000

Tab. 3 Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve të njësive ekonomike A dhe B në 31.12.20X2

	Njësia ekonomike A	Njësia ekonomike B
Të ardhurat nga shitja	120.000	50.000
Kosto e mallrave të shitur	100.000	30.000
Të ardhurat nga investimet financiare	?	x
FITIMI NETO	?	20.000

¹ Dir 34/2013, neni 9, pika 7(c)

Viti 20X1

Njësia ekonomike A

Në fund të vitit 20X1 njësia ekonomike rregullon vlerën e investimit financiar në pjesëmarrje për pjesën që i takon në fitimin e njësisë B në vitin respektiv. Supozojmë se pasqyrat financiare të njësisë ekonomike B për vitin 20X1 publikohen përpara publikimit të pasqyrave financiare të njësisë ekonomike A kështu që njësia A kontabilizon si më poshtë (*zakonisht në praktikë ndodh që ky veprim bëhet në vitin më pas*):

W1) Rregullohet investimi financiar në pjesëmarrje në përqindjen e kuotës së pjesëmarrjes në njësinë ekonomike B dhe bazuar tek fitimi neto i vitit 20X1 të njësisë B. Pra shuma e rregullimit është 3.000 euro (12.000 euro * 25%).

D Investime financiare në pjesëmarrje 3.000
K Të ardhura nga investimet financiare në pjesëmarrje 3.000

W2) Në vitin 20X1 njësia ekonomike A nuk mori dividendë nga investimet financiare në pjesëmarrje në njësinë ekonomike B, kështu që e gjithë e ardhura nga investimi do të paraqitet në rezerva, pra nuk do të kalohet tek fitimi i destinuar për t'u shpërndarë tek aksionarët.

D Fitime të pashpërndara 3.000
K Rezerva të tjera 3.000

Tab. 4 Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve të njësisë ekonomike A në 31.12.20X1

	Njësia ekonomike A
Të ardhurat nga shitja	120.000
Kosto e mallrave të shitur	100.000
Fitimi bruto	20.000
Të ardhurat nga investimet financiare (W1)	3.000
FITIMI NETO	23.000

Tab. 5 Pasqyra e pozicionit financiar të njësisë ekonomike A në 31.12.20X1

	Njësia ekonomike A
Aktive afatshkurtra	70.000
Investime financiare (W1)	8.000 (5.000 + 3.000)
Toka, ndërtesa dhe impiante	60.000
TOTALI I AKTIVEVE	138.000
Detyrime	75.000
Kapitali dhe rezervat	63.000
<i>Kapitali i nënshkruar</i>	<i>24.000</i>
<i>Rezervat (W2)</i>	<i>3.000</i>
<i>Fitimet e pashpërndara (W2)</i>	<i>36.000</i> <i>(16.000 + 23.000 – 3.000)</i>
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT	138.000

Kështu që, fitimet e pashpërndara të njësisë ekonomike A në datë 31.12.20X0, shtohen me fitimin e vitit 20X1 në shumën 23.000 euro dhe pakësohen me shumën 3.000 (pjesa e fitimit në njësinë ekonomike B) e cila kalon në rezerva sepse njësia ekonomike B nuk shpërndau dividend.

Viti 20X2

Supozojmë se në vitin 20X2, në muajin Korrik, njësia ekonomike B deklaron dividendë për t'u shpërndarë në vlerën 60% të fitimit sipas PF të viti 20X1, pra do shpërndajë një pjesë të fitimit në shumën 7.200 euro ($12.000 * 60\%$). Njësia ekonomike A e reflekton këtë njoftim në kontabilitetin e vet si më poshtë:

W3) Paraqitja e të drejtës së arkëtueshme për dividendët e deklaruar nga njësia ekonomike B, në shumën 1.800 euro ($7.200 * 25\%$)

D Të drejta të arkëtueshme 1.800
K Investime financiare në pjesëmarrje 1.800

W4) Arkëtimi i dividendëve të deklaruar më parë paraqitet:

D Mjete monetare në bankë 1.800
K Të drejta të arkëtueshme 1.800

W5) Ripozicionohet (stornohet) rezerva për shumën e dividendëve të arkëtuar.

D Rezerva të tjera 1.800
K Fitime të pashpërndara 1.800

Në vijim, shuma e investimit financiar në pjesëmarrje duhet rregulluar me fitimin e realizuar në vitin 20X2 nga njësia ekonomike B. Le të supozojmë të njëjtën situatë: njësia ekonomike B publikon pasqyrat e saj financiare përpara publikimit të pasqyrave financiare të njësisë ekonomike A. Kështu që, njësia ekonomike A në fund të vitit 20X2 bën këtë regjistrim kontabël:

W6) Rregullohet vlera e investimit financiar për kuotën e pjesëmarrjes në fitimin e vitit 20X2 të njësisë ekonomike B në shumën 5.000 euro (20.000 * 25%)

D Investime financiare në pjesëmarrje 5.000
K Të ardhura nga investimet financiare në pjesëmarrje 5.000

W7) Në të njëjtën kohë, për sa kohë dividendët nuk janë arkëtuar akoma, kjo shumë kur të hartohet pasqyra e pozicionit financiar do të paraqitet në rezerva:

D Fitime të pashpërndara (viti 20X2) 5.000
K Rezerva 5.000

Kështu që, më 31.12.20X2 vlera e investimit financiar në pjesëmarrje do të jetë 11.200 euro (5.000 + 3.000 – 1.800 + 5.000) dhe rezerva do të jetë 6.200 euro (3.000 – 1.800 + 5.000).

Tab. 6 Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve të njësisë ekonomike A në 31.12.20X2

	Njësia ekonomike A
Të ardhurat nga shitja	120.000
Kosto e mallrave të shitur	100.000
Fitimi bruto	20.000
Të ardhurat nga investimet financiare (W6)	5.000
FITIMI NETO	25.000

Tab. 7 Pasqyra e pozicionit financiar të njësisë ekonomike A në 31.12.20X2

	Njësia ekonomike A
Aktive afatshkurtra	91.800
Investime financiare (W3), (W6)	11.200 (5.000 + 3.000 – 1.800 + 5.000)
Toka, ndërtesa dhe impiante	60.000
TOTALI I AKTIVEVE	163.000

Detyrime	75.000
Kapitali dhe rezervat	88.000
<i>Kapitali i nënshkruar</i>	<i>24.000</i>
<i>Rezervat (W5), (W7)</i>	<i>6.200</i> <i>(3.000 – 1.800 + 5.000)</i>
<i>Fitimet e pashpërndara (W5), (W7)</i>	<i>57.800</i> <i>(36.000 + 25.000 + 1.800 – 5.000)</i>
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT	163.000

Konkluzione:

Më 31.12.20X2 investimet financiare (interesi pjesëmarrës i njësisë ekonomike A tek njësia ekonomike B) do të vlerësohet me 11.200 euro në të njëjtën kohë, fitimi që realizohet nga interesi në pjesëmarrje për vitin 20X1 në shumën 3.000 euro, do të jetë i mundshëm për t'u shpërndarë deri në shumën 1.800 euro, pra sa shuma e arkëtuar e dividendit, diferenca paraqitet në rezerva. Fitimi i realizuar nga interesi në pjesëmarrje në vitin 20X2 në shumën 5.000 euro nuk është i mundshëm për t'u shpërndarë prandaj kalon i tëri në rezerva.

Njësia ekonomike B nuk kontabilizon ndonjë transaksion si më sipër në lidhje me rregullimin e interesit të pjesëmarrjes sipas metodës së kapitalit.